

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE**

PËR ARSIMIN E MESËM

NË LËNDËN:

NJOHURI PËR SHOQËRINË

VITI MËSIMOR 2007-2008

TIRANË 2008

Udhëzime për zbatimin e programit

1. Të përgjithshme

Programi orientues për lëndën me zgjedhje Njohuri për shoqërinë, përfshin koncepte më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndës. Ky program është bazuar në programet ekzistuese të lëndës Njohuri për shoqërinë të zhvilluar në vitin e parë dhe të dytë të shkollës së mesme të përgjithshme të profilizuar ose jo

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës Njohuri për shoqërinë, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2007-2008, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme të përgjithshme, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e lëndës Njohuri për shoqërinë të shkollave të mesme të përgjithshme që do të përgatisin maturantët për provimin e saj si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për materialet kyç mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës Njohuri për shoqërinë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës Njohuri për shoqërinë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të të interesuarve.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës Njohuri për shoqërinë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë njohuri dhe koncepte të trajtuara në tekstet e vendosura për këtë provim (shih më poshtë).

Mësuesit që do përgatitin nxënësit për provimin e lëndës Njohuri për shoqërinë, duhet t'i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por duhet të trajtojnë dhe çështje që nuk parashikohen në program, por përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës Njohuri për shoqërinë, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve sociologjike dhe të shprehive të përcaktuara në program.

2. Udhëzim i veçantë

Testi në lëndën **Njohuri për shoqërinë** do të ndërtohet duke u bazuar në kërkesat dhe objektivat e programit të lëndës

Testi synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën **Njohuri për shoqërinë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet e vendosura më sipër.

Kjo do të thotë se:

1. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës, Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t'u testuar në këtë provim
2. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë zhvillimit të lëndës në shkollë të tilla, si:
 1. Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual)
 2. Aftësia për të shpjeguar dhe analizuar (nivel mesatar intelektual)
 3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual)

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- ☞ **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (për shembull ministrat ose jo të prekshme (për shembull koncepte të tilla si drejtësia, barazia etj). Të identifikosh diçka do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- ☞ **Të përshkruash** do të thotë dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- ☞ Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.
- ☞ Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët

përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara

- ☞ Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar për shembull për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- ☞ Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- ☞ Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli u ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni që mund të maten/vlerësohen me anë të:

1. testeve që varen nga një kontekst i caktuar në të cilën nxënësi pasi lexon ose analizon një material të caktuar informativ, plotëson një ose më shumë detyra
2. eseve me përgjigje të kufizuara
3. eseve me përgjigje të zgjeruara

1. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar janë për shembull, aftësitë:

1. Për të dalluar lidhjet shkak-pasojë
2. Për të dalluar zbatimin e parimeve
3. Për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen
4. Për të dalluar hipoteza të arsyeshme

5. Për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara janë, për shembull, aftësitë:

1. Për të shpjeguar lidhjet shkak-pasoja
2. Për të përshkruar zbatimin e parimeve
3. Për të paraqitur argumente të vlefshme
4. Për të formuluar hipoteza të arsyeshme
5. Për të formuluar përfundime të vlefshme

3. Rezultate të nxëni që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara janë për shembull, aftësitë:

- Për të prodhuar, organizuar dhe shprehur ide
- Për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes
- Për të krijuar modele origjinale
- Për të vlerësuar ide të vlefshme

3. Materiali burimor për përgatitjen e nxënësit për testimin në lëndën me zgjedhje Ekonomi dhe Hyrje ne filozofi

Materiali burimor që do të përdoret nga maturantët, mësuesit e tyre dhe autorët e testeve për provimin me zgjedhje në lëndën Njohuri për shoqërinë kanë këto të dhëna:

1. Teksti me titull: "Sociologjia 1, për vitin e parë të shkollës së mesme

Autori: **Zyhdi Dervishi.**

Botimi i parë: 1999.

Ribotimi i katërt: 2003.

2. Teksti me titull: "Njohuri për shoqërinë 2", për vitin e dytë të shkollës së mesme

Autorë: **Zyhdi Dervishi, Astrit Dautaj .**

Botimi i parë: 2004.

Ribotimi 2006, 2007

Këto tekste janë të vlefshëm për të gjitha shkolla e mesme të përgjithshme dhe të profilizuara !

Programi tematik

Kreu I. Kultura

1. Përcaktimi i kulturës
 - Kultura si karakteristikë vetëm njerëzore
2. Simbolet kulturore
 - Kuptimi sociologjik për simbolin kulturor.
 - Funkzionet sociale të simboleve kulturore.
3. Gjuha
 - Përcaktimi sociologjik i gjuhës.
 - Funkzionet e gjuhës.
4. Vlerat kulturore
 - Përcaktimi sociologjik për vlerat kulturore dhe roli i tyre në socializimin e anëtarëve të kulturës.
 - Vlerat kryesore të kulturës tradicionale shqiptare dhe funksionet e veçanta sociale të tyre në periudha të caktuara historike.
5. Normat kulturore
 - Kuptimi sociologjik për normat kulturore.
 - Shumëllojshmëria e normave kulturore. Reagimi i anëtarëve të kulturës në përputhje me rëndësinë e normës që shkelet. Brendësimi i normave kulturore.
 - Rëndësia e normave kulturore në kulturën tradicionale të popullit tonë.
6. Kultura materiale
 - Kuptimi sociologjik për kulturën materiale dhe funksionet sociale të saj.
 - Kultura materiale si shprehje e kulturës shpirtërore.
 - Kultura materiale dhe mënyra e jetesës e anëtarëve të kulturës.
7. Larmia kulturore
 - Kuptimi sociologjik për “nënkulturën”. Faktorët e larmitetit nënkulturor të kulturës shqiptare.
 - Kuptimi sociologjik për kundërkulturat.
 - Raporti me kulturën sunduese i nënkulturave dhe i kundërkulturave.
8. Zhvillimi i kulturës
 - Si ndryshon dhe zhvillohet kultura.
 - Faktorët kryesorë përcaktues të zhvillimit të kulturës: mjedisi gjeografik, përparimet teknologjike; zbulimet shkencore; prirjet vetzhvilluese të kulturës; rastësia historike dhe difuzioni kulturor.
 - Ligjësitë e procesit të difuzimit.
 - Roli i difuzionit në përparimin e kulturës shqiptare. Veçori të difuzimit të kulturës shqiptare me ato të popujve fqinj.
9. Si vlerësohen kulturat
 - Etnocentrizmi
 - Ksenocentrizmi
 - Relativizmi kulturor.

Kreu II. Familja

1. Martesa, familja, farefisnia
 - Martesat dhe format kryesore të saj
 - Përcaktimi sociologjik për familjen. Fazat kryesore të familjes.
 - Përcaktimi sociologjik i farefisnisë
2. Funksionet kryesore të familjes
3. Divorcimi dhe shoqëria bashkëkohore.
 - Faktorët kryesorë që nxisin divorcin dhe momentet e divorcimit.
 - Ndikimet komplekse të divorcimit të prindërve në jetën e fëmijëve.
4. Jeta familjare dhe anët e errëta të saj.

Kreu III. Komunikimi masiv

1. Komunikimi masiv.
2. Nivelet kryesore të komunikimit.
3. Gazeta, radio dhe televizioni.

Kreu IV. Feja

1. Feja dhe funksionet shoqërore të saj.
2. Tipat e organizatave fetare.

Kreu V. Shoqërizimi

1. Shoqërizimi dhe përvoja shoqërore
 - Përcaktimi sociologjik i shoqërizimit.
 - Shpjegimet kryesore.
 - Shoqërizimi dhe zhvillimi i personalitetit.
2. Mjediset dhe faktorët e shoqërizimit.

Kreu VI. Shkenca dhe teknologjia

1. Shkenca dhe teknologjia në sfondin e zhvillimeve historike
 - Përcaktimi i shkencës dhe i teknologjisë
 - Shkenca dhe teknologjia në rrjedhën e kohës
 - Si përparon mendimi shkencor
 - Shkenca dhe shkencëtarët në shoqërinë moderne
 - Zhvillime të shkencave shqiptare.

Kreu VII. Devianca

1. Kuptimi dhe interpretimi sociologjik i deviancës
2. Shpjegimet e shmangies (deviancës)
3. Funksionet shoqërore të deviancës.

Kreu VIII. Popullsia dhe urbanizimi

1. Dukuri dhe tregues të zhvillimit të popullsisë.

2. Urbanizimi: zhvillimi i qyteteve paraindustriale.
3. Industrializimi dhe shpejtimi i zhvillimit urban.
4. Interpretime sociologjike të jetës shoqërore në qytete.

Kreu IX. Racat dhe etniciteti

1. Racat dhe etnitë në sistemin e marrëdhënieve shoqërore.
2. Marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne.
3. Pakicat kombëtare dhe grupet etnike në Shqipëri.

Edukimi qytetar demokratik

Kreu I. Ç'është demokracia

1. Koncepti i demokracisë
2. Praktikrat e demokracisë
3. Pse duhet të zgjedhim demokracinë
 - ☞ Argumentet që justifikojnë demokracinë

Kreu II. Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë

1. Faktorët themelorë që modelojnë një demokraci
2. Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë
 - ☞ Faktorët që lidhen me tiparet e shoqërisë si një e tërë
 - ☞ Karakteristikat e individit si anëtar i shoqërisë
 - ☞ Karakteristikat e udhëheqësve politikë dhe nëpunësve

Kreu III. Funkcionimi i demokracisë

1. Institucionet, llojet dhe roli i tyre në funksionimin e demokracisë.
2. Struktura e qeverisë.
3. Debati dhe roli i tij në funksionimin e demokracisë.
4. Roli i partive politike në funksionimin e demokracisë.
5. Zgjedhjet dhe roli i tyre i tyre në funksionimin e demokracisë.

Konceptet kryesore të lëndës

Kujdes!

1. **Konceptet e mëposhtme, përmbajtja ose përkufizimet e tyre do të shihen të lidhur ngushtë në kontekstin e teksteve Sociologjia 1 dhe Njohuri për shoqërinë 2, të vendosur për provimet me zgjedhje të maturës shtetërore.**
2. **Konceptet e mëposhtme nuk janë shteruese. Ato ndriçojnë dhe theksojnë disa nga problemet kryesore në të cilat duhet të mbështeten nxënësit, mësuesit dhe autorët e testeve. Kjo do të thotë që përdoruesit e këtij programi nuk duhet të kufizohen vetëm**

në këto koncepte, por të mbajnë parasysh edhe çështjet e përzgjedhura më sipër, si dhe kuadrin konceptual në të cilin këto koncepte trajtohen

- ☞ Kulturë, simbol kulturor, gjuhë si tërësi simbolesh kulturore, vlerë kulturore, normë kulturore, folkuejs, norma urdhëruese, norma udhëzuese, norma ndaluese, tabu, kulturë materiale, nënkulturë, kundërkulturë, difuzion kulturor, prirje vetzhvilluese e kulturës, etnocentrizëm, ksenocentrizëm, relativitet kulturor, shok kulturor.
- ☞ Martesë, endogami, ekzogami, monogami, poligami, poligini, poliandri, bashkëjetesë, familje, farefisni, familje e hapur, familje patriarkale, familje bërthamë e mbyllur, divorc, dhunë brenda familjes, abuzim seksual.
- ☞ Nivel komunikimi, komunikim vetvetor, komunikim ndërpersonal, komunikim në grup, komunikim masiv, element komunikimi, mesazh mediatik, komunikim, kode, seleksionues, rregullatorë, filtra, auditorë, ndikime, çrregullime, fidbek.
- ☞ Fe, e shenjtë, profane, magjike, organizatë fetare, sekt, kult, pluralizëm fetar, tolerancë fetare.
- ☞ Shoqërizim, personalitet, vetja shoqërore, tjetri i përgjithësuar, shoqërizimi i parashikuar, opinion publik, rishoqërizim, fazë shoqërizimi, institucion i posaçëm shoqërizimi, agjenci shoqërizimi, masmedia, familja, shkolla, grupet e shokëve të ngushtë.
- ☞ Shkencë, teknologji, zbulim i shumëfishtë, shkencë normale, revolucion shkencor, ideal shkencor, universalizëm, dyshimi i organizuar, komunalitet, paineresshmëri.
- ☞ Devianca, inovacion, ritualizëm, tërheqja, rebelimi, etiketimi, krim,.
- ☞ Demografi, lindshmëri, vdekshmëri, shtesë natyrore e popullsisë, migrimi, emigrimi, teoria e ndryshimit demografik, urbanizim, urbanizimi bashkëkohor, industrializim, revolucion urban, shpërqendrim urban, përtëritje urbane, rajone urbane, ekologji urbane, modeli i zonave bashkëqendrore, modeli sektorial, qytete me shumë qendra, struktura e brendshme e qyteteve.
- ☞ Racë, etnicitet, pakica etnike, paragjykime etnike dhe racore, diskriminim etnik dhe racor, paragjykim institucional, pluralizëm etnik, asimilim i grupit etnik ose minoritar, veçim i grupit racia, etnik ose minoritar.
- ☞ Demokraci, demokraci e drejtpërdrejtë, demokraci përfaqësuese, politika dhe vlera shoqërore, struktura shoqërore, qëndrim shoqëror, institucion, strukturë e qeverisjes funksion legjislativ, funksion ekzekutiv, funksion gjyqësor, pavarësi e pushteteve, Debat publik, debat jo publik, elitë parti politike, zgjedhje, votim, përfaqësim individual dhe proporcional, fushatë elektorale, toleranca politike, intolerancë.

Sugjerim për shpërndarjen e pikëve që do të zënë krerët e përfshirë në program

Sociologjia

Kreu I: 23%

Kreu II: 8%

Kreu III: 7%

Kreu IV: 5%

Kreu V: 5%

Kreu VI: 5%

Kreu VII: 7%

Kreu VIII: 10%

Kreu IX: 7%

Edukimi qytetar demokratik

Kreu I: 7%

Kreu II: 5%

Kreu III: 12%